

progetto co-finanziato da



UNIONE  
EUROPEA




MINISTERO  
DELL'INTERNO

Fondo Europeo per l'Integrazione di cittadini di Paesi terzi

Kiti i pritjes  
ASTI

SISTEMA ABITARE: la forza della rete



*shënime lidhur me shtëpinë*



Progetto promosso da



Fondazione  
Don Mario Operti



In collaborazione con



Città di ASTI



## QERAJA

Të marrësh me qera një banesë do të thotë të nënshkruash një kontratë me pronarin. Kontrata duhet gjithmonë të regjistrohet pranë agjensisë së të ardhurave (agenzia delle entrate) brenda 30 ditësh nga data e nënshkrimit të kontratës. Shpenzimet e regjistrimit përpjestohen në mënyrë të barabartë mes pronarit dhe qeramarrësit. Në çastin e nënshkrimit të kontratës së qerasë, qeramarrësi duhet:

- t'i derdhë pronarit një depozitë parashë për tutelën e tij në rast se qeramarrësi nuk paguan rregullisht. Depozita ka një vlerë sa trefishi i pageses mujore të qerasë. Kur qeramarrësi lë banesën, pronari është i detyruar t'i kthejë atij shumën e depozitës në rast se marrëdhënia mes palëve ka qenë gjithmonë e perpiktë dhe banesa nuk është e dëmtuar.
- Të nënshkruajë kontratat me kompaninë përkatëse për furnizimin shtëpiak me gaz, ujë, energji elektrike, linjë telefonike: nëse kontratat janë ekzistuese, qeramarrësi duhet t'i vërë në emrin e vet ose t'i aktivizojë ato nga e para.

Qeraja zakonisht paguhet brenda datës 5 të çdo muaji. PAGESA mund të kryhet me derdhje në llogarinë bankare në emër të pronarit, buletin postar, para në dorë (për një vlerë jo më të lartë se 999,99 €) duke kërkuar gjithmonë një kupon pagese nga ana e pronarit e paisur me pullë takse prej 2,00 €.

### DOKUMENTAT E NEVOJSHME PËR TË MARRË ME QERA NJË BANESË

- kartë identiteti
- kodi fiskal
- të ardhurat e rregullta e të vazhdueshme
- letër qëndrimi (permesso di soggiorno) për të huajt.

### MUND TË NDËRPRITET KONTRATA? SI I BËHET?

- **Qeramarrësi** mund të ndërpresë kontratën para afatit duke i dërguar pronarit një letër me rekomandim 6 muaj para datës kur do të largohet nga shtëpia duke justifikuar arsyet.
- **Pronari** mund të ndërpresë kontratën vetëm kur të vijë skadenca më e afërt duke i justifikuar arsyet.



## CILAT JANË SHPENZIMET PËR HESAP TË QERAMARRËSIT?


- Të gjitha shpenzimet e zakonshme:
  - › shërbimet e pastrimit të hapsirave të përbashkëta (shkallë, hyrje, oborr)
  - › dritat e shkallës
  - › ashensori (mirëmbajtja paguhet sipas katit)
  - › uji (zakonisht paguhet sipas numrit të pjestarëve të familjes)
  - › shpenzimet e konsumit shtëpiak për drita, gaz, telefon.
- **Ngrohja:** në rast se është e centralizuar i paguhet administratorit të godinës, në rast se është më vete paguhet me faturën e gazit.

## CILAT JANË SHPENZIMET QË PAGUAN PRONARI

- Të gjitha shpenzimet e mirmbajtjes së jashtëzakonshme.

## KËSHILLOHET

Është e mira të kërkohen dhe të ruhen faturat e pagesave për llogari të pronarit dhe administratorit me datë e me firmë të personit/ kompanisë që merr paratë.



# BLERJA



Para se të vendosni te blini shtëpinë tuaj është mirë të këshilloni një agjensi imobiliare ose një teknik të jashtëm për të verifikuar gjendjen e shtëpisë. Agjensitë imobiliare mund të kryejnë këtë detyrë dhe bëhen ndërmjetës mes shitësit (pronarit) dhe blerësit: agjensia duhet të paguhet nga të dyja palët. Pasi kryhen këto verifikime dhe zgjidhet shtëpia, bëhet propozimi me shkrim për akordimin dhe bllokohet çmimi i shtëpisë për të cilin të dyja palët kanë rënë dakort. Nga ky çast, blerësi nuk mund ta hajë më fjalën, por shitësi mund të refuzojë ofertën e blerësit. Kur palët nënshkruajnë propozimin paraprak përcaktohet kompromisi, ku tregohen të gjitha nenet që më pas do të përfshihen në kontratën e shitblerjes e cila përcaktohet me shkrim para noterit në prani të palës shitëse dhe asaj blerëse.

## KINI PARASYSH

- Noteri paguhet prej blerësit.

## KUSHTET E DOMOSDOSHME PËR BLERJEN E SHTËPISË.

- Paisja me leje qëndrimi (permesso di soggiorno) për arsye pune ose familjare.
- Të qënurit në mardhënie pune të rregullt dhe rregullisht.

## KREDITË

Për të blerë një shtëpi mund të kërkohet një kredi në bankë. Normalisht bankat nuk financojnë më shumë se 70% të vlerës së shtëpisë që do blerë, prandaj edhe blerësi duhet të jetë menjëherë i gatshëm të paguajë rreth 30% të vlerës.

## Dokumentat që i duhen bankës për të dhënë kreditin:


- dokument identifikimi dhe kodi fiskal
- paga mujore
- deklarat e të ardhurave.

Lëshimi i kredisë ka një kosto.

Në rastin e blerjes së shtëpisë me anë të kredisë, bankës o jepet si garanci shtëpia vetë, e cila hipotekohet. Në rast se kredia nuk shlyhet brenda afatit të duhur, banka mund të marrë peng shtëpinë.

## KINI PARASYSH

- Në rast se i drejtoheni agjencisë imobiliare jeni të detyruar të merrni faturën e pagesës
- është i detyrueshëm të regjistrohet kompromisi i shitblerjes pranë zyrës së regjistrimit me shpenzime njëjloj të përpjestuara mes dy palëve
- në çastin e firmosjes së kompromisit, blerësi duhet të paguajë një shumë të pajtuar parashë në formë kapari që angazhon dy palët për nënshkrimin e aktit të shitjes. Në rast se pasi paguhet kapari blerësi nuk vendosë më të blejë shtëpinë në fjalë, zakonisht shitësi e mban kaparin e paguar. Kurse, në rast se shitësi nuk dëshiron më të shesë shtëpinë, blerësit mund t'i kthehet dyfishi i vlerës së kaparit të paguar prej tij
- përveç kostos së banesës, blerësi duhet të përbushë edhe të tjera shpenzime të tjera ( koston e marrëveshjes para-prake, kuotën e agjencisë imobiliare nëqoftëse vepron me ndërmjetësinë e saj, tarifën e noterit për nënshkrimin e aktit, taksa të tjera). Këto shpenzime ndryshojnë sipas vlerës së banesës.



# QERAJA ME TË DREJTË BLERJE



Është një formulë e përzier mes qerasë dhe blerjes. Përfshin disa mundësi, ndër të tjera edhe mundësinë e dhënies me qera të banesës e cila më pas mund të blihet nga qeramarrësi. Praktikisht kur blerësi/ qeramarrësi dëshiron të hyjë menjëherë në banesë, por nuk ka mundësi ekonomike për ta blerë atë menjëherë. Zakonisht kështu veprohet me pronarët privat ose më shpesh me sipërmarrje ndërtimi.

Në dekretin "Sblocca Italia" patashikohet rekuperimi fiskal i 20% të vlerës së blerjes së shtëpisë nëse brenda 6 muajsh vendoset të jepet me qera me kontratë të konkorduar.

## FORMAT KRYESORE TË KONTRATAVE ME TË DREJTË BLERJE

### ■ Qeradhënie me të drejtë blerje

Përfshin dy kontrata më vete, njëra kontratë qeraje dhe tjetra kontratë blerje që i jep mundësinë qeramarrësit/ blerës të jetojë menjëherë në shtëpi duke i mundësuar blerjen në përfundim të kontratës së qerasë.

Zakonisht në këto raste vlera e qerasë mujore është më e lartë se mesatarja.

### ■ Kontratë qeraje me pakt shitjeje

Është një kontratë me formë të përzier ku kontrata e qerasë dhe ajo e blerjes janë një. Pronari dhe qeramarrësi/ blerës vendosin që brenda afateve të kontratës së qerasë.

Qeratë e paguara me vlerë më të lartë se mesatarja janë njëfarë kapari në lidhje me vlerën e shitjes. Qeramarrësi mund të jetojë menjëherë në këtë shtëpi.

### ■ Premtim blerje me të drejtë dorëheqje nga ana e blerësit.


I drejtohet atyre që janë të interesuar të blejnë shtëpi brenda një periudhe të caktuar me afat të mesëm/ të gjatë.

Parashikon për blerësin mundësinë e dorëheqjes ose ndërhyrjen e një pale të tretë për blerjen e shtëpisë në fjalë..

### ■ Shitja me kusht mbi pronësinë.

Krijon mundësinë për të blerë shtëpi duke e paguar atë me këste dhe duke e banuar menjëherë.

Blerësi bëhet pronari i shtëpisë vetëm kur paguhet kësti i fundit.





# DËBIMI

Ndodh kur qeramarrësi detyrohet të lërë të lirë banesën që kishte marrë me qera. Ka disa arsye dëbimi.

## ■ Prishje e kontratës dhe dëbim për qeramarrje të rreme.

Kur skadon kontrata e qerasë, pronari vendosë të mos e japë më me qera shtëpinë. Duhet t'i dërgojë qeramarrësit një rakomandatë me riçevutë kthimi për prishjen e kontratës 6 muaj para skadimit të saj.

## ■ Dëbim për vonesa.

Ndodh kur qeramarrësi nuk paguan qeranë mujore dhe/ ose shpenzimet e konsumit (uj, drita, gaz, shpenzimet administrative) me vlerë sa dy muaj qera. Në rast të tillë, pronari i dergon direkt një letër qeramarrësit që e nxit për pagesat e prapambetura. Nëse pagesat e prapambetura nuk shlyhen brenda 15 ditësh pronari mund t'i drejtohet gjykatës për të vijuar me praktikën e dëbimit.

## ■ Dëbim për nevojat e pronarit.

Ndodh kur pronari vendos të përdorë shtëpinë për veten e vet. Zakonisht hyn në fuqi vetëm pas skadencës së parë të parashikuar nga kontrata.

## ■ Dhunime të rënda nga ana e qeramarrësit.

Ndodh kur qeramarrësi cënon rëndë kushtet e kontratës, si në rastin kur shtëpia e lëshuar me qera një pale të tretë nga ana e qeramarrësit.

Në komunat me probleme të medha strehimi, si në Asti, qeramarrësi mund të kërkojë pezullimin e dëbimit për qeramarrje të rreme nëse ndodhet në kondita familjare të veçanta (të ardhura të pakta, të mitur në ngarkim, të moshuar ose persona me aftësi të kufizuar në familje).

Në rast dëbimi është mirë t'i drejtoheni sindikatës së qeramarrësve.

## ÇFARË TË BËNI PAS DËBIMIT?

Mund t'i drejtoheni komunës përkatëse për të paraqitur kërkesën për të marrë pjesë në renditjen e listës së emergjencës strehimore. Në disa komuna të Piemontes është aktivizuar sistemi "Salvasfratti", që ndikon në pakësimin e numrit të të dëbuarve për arsye të vonesave të pagesave.

## DISA KONTAKTE

**Comune di Asti** - Settore Servizi Sociali  
Piazza Catena 3 - 14100 ASTI  
tel. 0141.3991 - [www.comune.asti.it](http://www.comune.asti.it)

### SICET

Via XX Settembre 10 - 14100 Asti  
tel. 0141 530266

### SUNIA

Piazza Marconi 26 - 14100 Asti  
tel. 0141 533534

### UNIAT

Corso Alessandria 220 - 14100 Asti  
tel. 0141 594882

# AGJENSIA SOCIALE E QERAVE C.A.S.A.



Agjencia sociale e qerave C.A.S.A është krijuar nga komuna e Astit në ndihmë të qeramarrësve përsa i përket kerkimit të banesës në tregun privat. Shërbimet e ofruara janë gratis dhe i drejtohen shtresave të ndryshme të popullsisë.

## Agjencia i drejtohet:

- Pronarëve të banesave të pa shfrytëzuara.
- Atyre që kërkojnë strehim në tregun privat.

Qeramarrësit për të përfitur nga shërbimi duhet të përmbushin këto kushte:

- të kenë rezidencë ose të punojnë në komunën e Astit prej të paktën një viti.
- të kenë shtetësinë italiane ose të një shteti UE, për shtetasit jo UE nevojitet leja e qëndrimit e vlefshme (permesso di soggiorno).
- të kenë ISEE jo më shumë se 26.000 €
- të mos kenë pronësi imobiliare për strehim.

Për qeramarrësit parashikohet një kontribut me fond të humbur që përkon me vlerën e:

- 8 qerave mujore për përfituesit me ISEE nën 6.186,00 €;
- 6 qerave mujore për përfituesit me ISEE nën 10.310,00 €;
- 4 qerave mujore për përfituesit me ISEE deri në 26.000,00 €.

Pronarët që lëshojnë banesat e tyre me qera mujore me ulje çmimi nën 25% krahasuar me vlerën maksimale të akordit territorial, i përket një kontribut me fond të humbur prej 1.500,00 €.

## NISMA "SALVASFRATTI"

Kjo nisën i përket rasteve të vonesave pa-faj që kanë si pasojë dëbimin. Agjencia sociale e qerasë C.A.S.A. propozon një rishikim të kontratës së qerasë.

"Salvasfratti", është një nisëm që parashikon një fond, i cili aktivizohet kur kemi të bëjmë me rastet e kamat vonesave të paqëllimshme dhe kur ka hyrë në fuqi dëbimi.

Agjencia sociale C.A.S.A propozon një rimiegocim të kontratës së qerasë duke e kthyer atë në formulën (3+2) karshi mbylljes së parakohshme të dëbimit.

Pronarit të shtëpisë i garantohet shlyerja e kamat vonesave të akumuluar deri në një maksimum prej € 8.000 dhe deri në përfundim të fondit.

## DISA KONTAKTE

### Agenzia sociale per la locazione C.A.S.A.

c/o Settore servizi sociali  
del Comune di Asti  
Piazza Catena 3  
14100 Asti  
Tel. 0141.399273  
[casa@comune.asti.it](mailto:casa@comune.asti.it)  
[www.comune.asti.it](http://www.comune.asti.it)



# BANESAT POPULLORE



Në mënyrë periodike komuna shpall zyrtarisht njoftimin për të marrë pjesë në garën e përfitimtë të shtëpisë popullore. Renditja përpilohet sipas nivelit të nevojave të familjeve që marrin pjesë.

## PARAQITJA E KËRKESËS: SI, KUR, KU?

Duhet përpiluar modeli i kërkesës që gjendet:

- pranë komunës që ka shpallur njoftimin.
- pranë shërbimit "Segretariato Sociale" të sektorit të shërbimit social.
- pranë zyrës URP të komunës së Astit (Piazza San Secondo, 1)
- [www.comune.asti.it](http://www.comune.asti.it)

Kërkesa duhet të paraqitet në periudhat e caktuara prej kalendarit organizativ, zakonisht çdo 4 vjet.

Datat gjenden pranë websiteve të komunave të ndryshme. Kërkesa dorëzohet pranë komunës që na intereson dhe që ka shpallur njoftimin.

Modeli i përpiluar dhe i paisur me pullë poste prej 16,00 € duhet të dorëzohet pranë shërbimit "**Segretariato Sociale**" të komunës së Astit.

Kërkesa mund të dorëzohet dorazi ose me postë të rekomanduar dhe riçevutë kthimi (A/R), në adresën:

**Comune di Asti - Ufficio Protocollo  
Piazza San Secondo, 1 - 14100 Asti**  
shoqëruar me dokument identifikimi të personit të interesuar.

## CILAT JANË KUSHTET PËR TË BËRË KËRKESË

Duhet plotësuar këto tre kushte

- rezidenzë ose marrdhënie pune pa ndërprerje prej të paktën 3 vjetësh në Asti, ose në njërin prej komunave që përfshihen në të njëjtin territor, plus
- pa pronësi ne Piemonte ose pa pronësi strehimi për familjen plus
- tregues ISEE nën vlerën 20.784,77 €.

Të dhënat e lartpërmendura duhet të paraqiten në formë vetdeklarate shoqëruar me modelin ISEE.

Mund të kërkojnë strehim popullor edhe personat që janë në gjendje emergjence strehimore në njërin nga këto raste:

- dëbimi për vonesë pagese të paqëllimshme ose për qera të rreme, pengmarrje, caktim i banesës bashkshortit/bashkëshores në rast ndarjeje.
- lënie e detyrueshme e banesës për dëbim.
- pabanueshmëri e shtëpisë.
- gjendje e refugjatit
- mysafir i fjetoreve ose i strukturave të tjera publike prej të paktën 3 muaj.





Kushtet e emergjencës strehimore duhet të verifikohen përmes dokumentave përkatëse (dëbimi, të ardhurat e familjes). Kërkesa bashkë me dokumentat duhen paraqitur pranë sportelit "Segretariato Sociale" pranë komunës së Astit.

### **SHPALLJA E REZULTATIT PERFUNDIMTAR**

Lista me renditjen e përfituesve të së drejtës për strehim në banesë popullore publikohet nga komunat e territorit dhe në selinë A.T.C që më pas merret me caktimin dhe shoqërimin e personave në banesat përkatëse.

### **VINI RE**

- Shtëpia popullore nuk trashigohet.
- Kur caktohet shtëpia duhet vajtur pranë A.T.C në ditën e takimit për nënshkrimin e konvencionit dhe për të paguar përnjëherësh shpenzimet e kontratës.
- Vlera e qerasë mujore përcaktohet herë pas here në bazë të karakteristikave të banesës dhe kushteve sociale dhe ekonomike të familjes: vlera minimale e qerasë vjetore është 40,00 €. Qeramarrësi duhet të paguaj shpenzimet për administrimin e godinës dhe ngroftjen.

- Është i domosdoshëm autorizimi nga ana e A.T.C për futjen e një mysafiri në banesë.
- Çdo dy vjet duhet bërë detyrimisht regjistrimi socio-ekonomik i familjes pranë A.T.C.
- Çdo dy vjet shpallet lajmi i pjesëmarrjes për të përfituar nga Fondi Kombëtar në ndihmë të qerasë. Kjo është një ndihmë ekonomike për familjet me të ardhura të pakta. Për më shumë duhet të drejtoheni tek komuna e rezidencës.
- Është edhe Fondi Social Rajonal në ndihmë të pagesave të vonuara jo qëllimisht që i drejtohet vetëm për vetëm atyre që kanë përfituar banesa ERP.



# KOOPERATIVA E BANESAVE



## ÇFARË ËSHTË?

Është një shoqëri e përbërë nga persona që bëhen ortakë për të realizuar bashkërisht një të mirë imobiliare për ta përdorur më pas si banesë vetjake.

Njihen tre forma të ndryshme të kësaj kooperativash:

- **Me pronësi të pandashme:** banesat i jepen ortakëve për përdorim me afat të caktuar.
- **Me pronësi të ndashme:** banesat i jepen ortakëve për t'i dhënë pronësinë.
- **Me pronësi të përzier:** banesat i jepen ortakëve qoftë me qera, qoftë për përdorim, qoftë me prespektivën e pronësisë.

Për të mundur një gjë të tillë duhet të jetë i gatshëm një terren për realizimin e banesës. Zakonisht është më e thjeshtë t'i drejtoheni kooperativave ekzistuese dhe të mbështeteni tek ato.

## ÇFARË DUHET TË DINI PARA SE TË MBËSHTETENI TE NJË KOOPERATIVË

- mos ju besoni kooperativave që kërkojnë kuota të larta antarësie.
- verifikoni vërtetësimin e ekzistencës së kooperativës dhe vërtetësimin e regjistrimit të saj tek regjistri i kooperativave të ndërtimit.
- informohuni personalisht pranë zyrave komunale kompetente që merren me ndërtimet ekonomike dhe popullore.

- informohuni lidhur me seriozitetin dhe qëndrueshmërinë e kooperativës në bazë të punimeve të realizuara praktikisht prej saj dhe mundësisht dëgjoni drejtpërdrejtë qytetarët që kanë patur të bëjnë me kooperativën ku ju dëshironi të antarësoheni.

## PËR INFORMACIONE TË MËTEJSHME



### CONF COOPERATIVE ASTI


Via XX Settembre, 26

14100 Asti

Tel. 0141.357.111

fax 0141.357.150

[info@confcooperative.asti.it](mailto:info@confcooperative.asti.it)



# GODINA E PËRBASHKËT (CONDOMINIO) multikulturë dhe bashkëjetesë



Shtëpia është vendi më i përshtatshëm për t'u ndjerë rehat. Ka raste kur nga bashkëjetesa mund të lidin konflikte prandaj është e dobishme të promovohet dialogu për tu njoftuar dhe për tu kuptuar më së miri.

## IREGULLORJA E GIDINËS SË PËRBASHKËT (CONDOMINIOS)

Çdo assemble e përbashkët vendos rregullat e brendshme që duhen respektuar nga të gjithë banuesit/ qeramarrësit.

### Zakonisht është e ndaluar

- të zhvillohen aktivitete të zhurmshme para orës 7.00 dhe pas orës 22.00 si edhe nga ora 14.00 deri në 16.00.
- organizimi i aktiviteteve të koordinuara mes banorëve.
- të lihet hapur dera kryesore e godinës.
- vendosja e automjeteve, biçikletave, karrocave për fëmijë, etj, në pjesët e përbashkëta të mbuluara e të pambluara, të rezervuara për kalimin e këmbësorëve.
- hedhja e mbeturinave, copa letrash, filtra cigaresh, etj, nga ditaret, nëpër shkallë, në sheshpushime, në koridore, në oborre dhe në të gjitha vendet e tjera të përbashkëta.
- lënia e mbeturinave përjashta dyerve ose në vende të tjera të përbashkëta. Mbeturinat duhen hedhur, të mbyllura me qese plastike, në vendet përkatëse.

### Zakonisht lejohet:

- nderja e rrobave, veshjeve, nga dritaret dhe ballkonet me faqe nga oborri i përbashkët dhe brenda apartamenteve.
- transportimi i mobiljeve dhe objekteve përmes hapsirave të përbashkëta, me kujdes dhe pa shkaktuar dëme nëpër mure, shkallë, ashensor, dhe në fasadën e pallatit.
- instalimi i antenave televizive shtesë bëhet me autorizim paraprak të administratorit.

### Këshillohet

- prindërit duhet të bëjnë të mundur që fëmijët e tyre të sillen korektësisht dhe me respekt, pa uluritur dhe pa shkaktuar zhurma qe bezdisin fqinjët.

- në rast se mes fqinjëve lindin pakënaqësi dhe konflikte, palët duhet t'i drejtohen administratorit. Ankesat duhet të paraqiten me shkrim dhe me firmë.
- është e mira të kryhet korektësisht derdhja e diferencuar e mbeturinave për të evituar gjoba, që në këtë rast i përkasin të gjithë fqinjëve dhe jo vetëm atij që gabon. Fillimisht duhet të informoheni se si bëhet derdhja e diferencuar e mbeturinave në komunën përkatëse.
- këshillohet një mirëmbajtje e kujdesshme (kontrolli i impjanteve, rrjetëve, gjendja e dysHEMEVE, etj) dhe kushte optimale pastërtie dhe higjens në secilën banesë.

### MARËDHENIET E FOINJËSISË

Gjëja më e mirë është të krijohen marrëdhënie të përzemërta me fqinjtë. Nganjëherë mund të lindin probleme të vogla, shpeshherë për motive të dobta. Këshillohet të zgjidhen me mirkuptim dhe buonsens.



# IL SISTEMA ABITARE



## ÇFARË ËSHTË?

"Sistema abitare" është një rrjet entesh të ndryshme (ente lokale, organizata, shoqata, kooperativa, banka etj) që angazohen mbi tematikat e paisjes me shtëpi të personave në nevojë duke informuar korrektësisht dhe duke bashkëpunuar vazhdimisht mes tyre. Veprimtaria e tyre në këtë drejtim udhëhiqet nga një protokoll koordinues, principet e të cilit duhet të respektohen nga anëtarët që marrin pjesë në sistem.

Kjo nisëm ka lindur në Torino në vitin 2013 dhe është vënë në dispozicion të territorit piemontez për të ndarë bashkarisht eksperiencën dhe instrumentet.

Edhe qyteti i **Astit** ka vendosur të marrë pjesë.

## PËRSE DUHET TË DREJTOHENI TEK ENTET PJESËMARRËSE?

Për të qënë të sigurtë për:

- Për të patur informacione të sakta, të qarta dhe të azhornuara.
- Për t'u adresuar tek entet territoriale më të përshtatshme në zgjidhjen e nevojave dhe kërkesave.
- Për të biseduar me dialogues të gatshëm e të respektueshëm.
- Për të aktivizuar dhe shoqëruar resurset më të përshtatshme të territorit.

"Sistema abitare" ka përpiluar instrumente optimale për të patur informacione sa më të sakta lidhur me strehimin, të cilat gjenden pranë enteve pjesëmarrëse në sistem.

Po hartohet një program interneti që i lejon secilit të marrë menjëherë përgjigje lidhur me mundësitë e strehimit brenda territorit sips të dhënave personale.

"Sistema abitare" përfshin (deri ne Prill 2015) 50 subjekte aktive në Torino dhe ka nisur kooperimin me disa terriore piemonteze, ndër të cilat dhe **Asti**. Subjektet pjesëmarrëse identifikohen me siglën (cfr. sotto).

Informacione të mëtejshme luhur me subjektet pjesëmarrëse gjenden pranë siteve të enteve përkatëse dhe pranë sekretarisë në këto adresa.

**C.I.C.S.E.N.E.**

Via Borgosesia 30

10145 Torino

Tel. 011.74.12.435

[cicsene@cicsene.org](mailto:cicsene@cicsene.org)

[www.cicsene.it](http://www.cicsene.it)



[www.sistemaabitare.org](http://www.sistemaabitare.org)

Questo kit è prodotto nell'ambito del progetto "SISTEMA ABITARE: la forza della rete" co-finanziato dall'Unione Europea e dal Ministero dell'Interno Italiano - Dipartimento per le libertà civili e l'immigrazione nell'ambito del Fondo Europeo per l'Integrazione di cittadini di Paesi terzi, Azione 6 - Annualità 2013. I contenuti del testo rientrano sotto la sola responsabilità di C.I.C.S.E.N.E. e degli enti partner del progetto e non rispecchiano necessariamente il punto di vista dell'Unione Europea e del Ministero dell'Interno.

**Grafica:** zazi - torino    **Illustrazioni:** Monica Fucini

**Traduzione:** a cura delle antenne multiculturali attive nel "Sistema Abitare".

**CICSENE**

Via Borgosesia, 30 ■ 10145 TORINO  
Tel. 011.74.12.435  
[www.cicsene.it](http://www.cicsene.it)

**COMUNE DI TORINO**

*Direzione Edilizia Residenziale Pubblica*  
Via Corte d'Appello, 10 ■ 10122 TORINO  
[www.comune.torino.it/informacasa](http://www.comune.torino.it/informacasa)

**FONDAZIONE DON MARIO OPERTI onlus**

Via Cottolengo, 22 ■ 10153 TORINO  
Tel. 011.56.36.951  
[www.fondazioneoperti.it](http://www.fondazioneoperti.it)

**CONFCOOPERATIVE Unione Provinciale di Torino**

Corso Francia, 15 ■ 10138 TORINO  
Tel. 011.43.43.181  
[www.torino.confcooperative.it](http://www.torino.confcooperative.it)

**CONSORZIO COPEA - Società Cooperativa Edilizia**

Via Beaumont, 19 ■ 10138 TORINO  
Tel. 011.50.69.816  
[www.consorziocopea.com](http://www.consorziocopea.com)

**STRANAIDEA s.c.s. - Impresa Sociale onlus**

Via Paolo Veronese, 202 ■ 10148 TORINO  
Tel. 011.38.41.531  
[www.stranaidea.it](http://www.stranaidea.it)

**SYNERGICA s.c.s.**

Piazza Peyron, 26 ■ 10143 TORINO  
Tel. 011.20.72.276  
[www.synergicato.it](http://www.synergicato.it)